



Pranimi / Dorezuar Primiteno / Prodato Received / Delivety	28 - 10 2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2316 / 2020		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.261/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.261/2020 të datës 04.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë lagja "Bajraktari" në Junik, kundër Vendimit me Nr. Prot:328/20 të datës 04.08.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.261/2020 e datës 04.09.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. Prot:328/20 i datës 04.08.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Vendimi me Nr.466 i datës 17.06.2020 i U.d. Sekretares se Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe të gjitha njoftimet që rrjedhin nga ky vendim.

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të zbatojë këtë vendim duke lëshuar Akt Emërimin për ankuesin [REDACTED], brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimit të datës 10.09.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 14.09.2019 ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve" në Junik, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe kandidati [REDACTED]. Afati i aplikimit për këtë konkurs është vazhduar nga data 05.10.2019 deri me 11.10.2019.

Me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike me datë 07.10.2019 ka njoftuar të gjitha institucionet publike për hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publik dhe ka udhëzuar që të gjitha procedurat e konkurseve të cilat janë shpallur sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të pezullohen përkohësisht. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme me datë 08.10.2019 përmes shkresës Nr.782/19 të publikuar në webfaqe të Ministrisë ka njoftuar së është pezulluar procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve".

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më datë 25.11.2019 është pezulluar me Vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020 ka lëshuar njoftim me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar procedurën e pezulluar për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve" në Junik, ku ka themeluar Komisionin Përzgjedhës, ka organizuar testin me shkrim, intervistën me gojë dhe në tërësi ka përfunduar procedurën e rekrutimit me datë 26.02.2020 përmes publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm [REDACTED].

Më datë 17.06.2020 U.d. e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr Vendimin me Nr.466 me të cilin ka anuluar konkursin e datës 14.09.2019, me arsyetimin se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike preken nga procesi i fuzionimit apo bashkimit sipas Vendimit nr. 07-v-005 të datë 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe me arsyetimin se procedura e listës se ngushte është bërë jashtë afatit prej 5 dite të përcaktuar me Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.466 të datës 17.06.2020, më datë 07/07/2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme me pretendimin së konkursi është anuluar në kundërshtim me legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin Civil. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 04.08.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.328/20 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuses duke vërtetuar Vendimin me Nr.466 të datës 17.06.2020 të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi [REDACTED], kundër Vendimit me Nr. Prot:328/20 të datës 04.08.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 04.09.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1698/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky vendim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, si dhe aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme më datë 29.09.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, më datë 19.10.2020 ka nxjerr Vendimin VK.nr.3/2020 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.261/2020 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1698/2020 të datës 04/09/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 26/02/2020 për kandidatin e suksesshëm; E-mailin e datës 18/06/2020 dhe 23/06/2020 nga ankuesi; E-mailin e datës 19/06/2020 nga Vjollca Bruqi për ankuesin; Njoftimin për anulim të konkursit i datës 18/06/2020; Ankesën e ankuesit e datës 07/07/2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr. 466 e datës 17/06/2020 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Lista e pikëve të vlerësimeve datë 21/02/2020; Raportin përmbledhës i datës 21/02/2020; Autorizimin për publikimin e konkursit i datës 10/09/2019; Raporti Final i rekomandimi nga komisioni rekrutues i datës 21/02/2020; Pyetjet e intervistës me gojë; Lista e aplikantëve për intervistë me gojë e datës 14/02/2020; Lista e ngushtë e aplikantëve për testin me shkrim e datës 12/02/2020; Lista e aplikantëve sipas pikëve të fituara nga testi me shkrim e datës 12/02/2020; Formularin Form.MAP-SHCK-08 për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testi me shkrim i ankuesit i datës 12/02/2020; Formularin Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 06/02/2020; Formularin Form.MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin e regjistrimit të aplikacioneve të pranuar; Formularin e listës së shkurtër i datës 06/02/2020; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave të datës 06/02/2020; Vendimin e datës 05/02/2020 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Konkursin e datës 14/09/2020 i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve në Junik"; Njoftim i datës 08/10/2019; Njoftimin e datës 10/01/2020 i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 26/09/2020; Kontratë për ofrimin e shërbimeve analist kredie e datës 10.10.2013; Kontratë Punësimi e datës 25/07/2014; Ankesë kontratë e datës 12/03/2014, 22/08/2016; Kontratë Punësimi e datës 19/11/2015, 02/02/2016; Diplomën e ankuesit e datës 08/06/2011; Kërkesën për shtyrje të afatit e datës 19/10/2020; Vendimin me VK.nr.3/2020 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDACTED] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit sipas të cilës procedura e rekrutimit është anuluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ka konstatuar së U.d. e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.466 të datës 17.06.2020 për anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve në Junik" me arsyetimin se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike preken nga procesi i bashkimit sipas Vendimit Nr.07-v-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 32

paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Nr.08-2012 për Nëpunësit Civil Tepricë, ku përcaktohet së në rast të suprimimit ose bashkimit të një institucionin me një institucion tjetër, organi mbikëqyrës i institucionit përkatës, me vendim, cakton organin apo trupën punuese për hartimin dhe menaxhimin e programit për nëpunës civilë tepricë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton së Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr.466 të datës 17.06.2020 për anulimin e konkursit mbi bazën e riorganizimit ka dështuar të ofroje argumente të dokumentuara së pozita "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve" është identifikuar si pozite e cila do të shuhet pas bashkimit me Ministrinë e Administratës Publike. Kolegji, po ashtu vlerëson se vetëm Vendimi Nr.07-v-005 i datës 03.02.2020 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për bashkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Ministrinë e Administratës Publike, pa një plan të tranzicionit të aprovuar nga organet kompetente, nuk është baze e mjaftueshme për anulimin e konkursit në një faze të procedurës ku kandidati ka fituar të gjitha të drejtat për emërim në Shërbim Civil.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar vendimin me Nr.466 të datë 17.06.2020 për anulimin e konkursit me arsyetimin se është shkelur neni 26 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, meqenëse ka shpallur konkursin për pozitën e lartcekur më datë 14.09.2020, i njëjti konkurs është pezulluar sipas njoftimit të datës 08.10.2019, por pas krijimit të rrethanave të reja respektivisht pas njoftimit të datës 10.01.2020 të Ministria e Administratës Publike si ministri përgjegjëse për administrimin e Shërbimit Civil, për vazhdimin e procedurave sipas dispozitave të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës" atëherë Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar procedurën e rekrutimit, ku më datë 05/02/2020 ka nxjerr Vendim me Nr.78/20 me të cilin ka bërë themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, pastaj i njëjti komision më datë 06/02/2020 ka përcaktuar kriteret për përfshirje në listë të shkurtër dhe në të njëjtën ditë ka përgatitur listën e shkurtër, më datë 12/02/2020 është mbajtur testi me shkrim për kandidatët e listës së shkurtër ndërsa më datë 14/02/2020 është mbajtur testimi me gojë për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim, mbi bazë të këtyre Kolegji për shqyrtimin e vendosjen e ankesave, konstaton se lista e shkurtër për këtë pozitë është përgatitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 26 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu procedura e themelimit të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, testimi me shkrim dhe testimi me gojë është zhvilluar në pajtim me nenin 7, 36 dhe 38 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Kështu që Vendimi me Nr. 466 i datë 17/06/2020 i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme për anulim të konkursi siç u theksuar edhe më lartë është në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.08/2010 për Nëpunësit Civilë Tepricë, sepse arsyetimi i këtij vendimi është i pa bazë dhe në kundërshtim të plotë me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij" dhe nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative...është në kundërshtim me ligjin material" mbi këtë bazë pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kriteret e konkursit për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve" në Junik të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme kanë qenë: "Diplomë universitare: Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik ose shkenca tjera shoqërore pa përvojë pune ose Shkollë e lartë së paku dy vite përvojë pune", si rrjedhojë në bazë të kriterëve të konkursit ankuesi ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit si tek përgatitja profesionale po ashtu edhe tek përvoja e punës, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të kësaj procedure konstaton se kjo procedurë e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 11 paragrafit 1, nenit 18 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar që kjo procedurë është zhvilluar në pajtim me legjislacionin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë Ministria e Punëve të Brendshme pas shpalljes se njoftimit për kandidatin e suksesshëm ka qenë e obliguar që ankuesit t'i lëshoj Akt Emërimit në pajtim me nenin 19 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 41 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullore Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civilë, meqenëse kandidati i suksesshëm [REDAKTUAR] ka arritur numri me të madh të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë siç përcaktohet me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.328/20 të datës 04/08/2020 me të cili ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me Nr.466 të datë 17/06/2020 të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit duke mos vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës, konstaton që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme është i obliguar që në pajtim me raportin final të Komisionit Përzgjedhës dhe në pajtim me dispozitat e nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 41 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe dispozitave të Rregullores Nr. 07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil, të bëjnë lëshimin e Akt Emërimit për kandidatin e suksesshëm [REDAKTUAR] për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Automjeteve" në Junik.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.261/2020

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

